



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 03.10.2024, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1017/24-A, për zyrtarin e lartë z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë të sipërpërmendur, ku theksohet se (citojmë nga kërkesa): “[...] Ju shkruaj për të marrë një përgjigje nga ana e juaj se a ka bazë për nisje të hetimeve nga AKK për një rast që përmes një hulumtimi së fundi e kemi publikuar në [...]. Bëhet fjalë për tre tendera të Ministrisë së Shëndetësisë ku pronari i dy kompanive përfituese dyshohet për konflikt interesi me [...] zyrtarë të lartë të Ministrisë Shëndetësisë [...]”.

Tutje në këtë raportim thuhet se: “... zyrtarë të lartë të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), njëri sekretari Naim Bardiqi dhe tjetri [...], dyshohet se janë përfshirë në një konflikt interesi me një kompani të huaj. Kompania irlandeze “Klmegeo Consulting” L.L.C, e regjistruar në Kosovë si biznes më 24 mars të vitit 2023, ishte angazhuar edhe në të kaluarën nga Ministria e Shëndetësisë në disa projekte, në mesin e të cilave edhe në projektin për hartimin e Strategjisë së Sektorit të Shëndetësisë së Kosovës për vitet 2017 – 2021. Me rastin e regjistrimit si biznes në Kosovë, “Kimegeo Consulting” L.L.C - si person kontaktues kryesor në ARBK - ka vendosur numrin personal të Sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë, Naim Bardiqit, [...]. Shërbimet e

kryera nga Bardiqi [...] për kompaninë Klmeqo, i ka konfirmuar edhe vet Th. W., në një përgjigje për raportuesin e rastit (v.j.). [...] Sipas tij, atij i është kërkuar nga organet kompetente kosovare që me rastin e regjistrimit të biznesit, të shtojë një numër të një operatori të Kosovës dhe të hapë një llogari bankare në ndonjërin nga bankat në Kosovë, me qëllim të pagesës së TVSH-së për shërbimet e kryera. Për këtë, thotë se ka kërkuar ndihmën e Bardiqit [...], ani pse nuk është përgjigjur se si i ka njohur të njëjtit dhe pse në ARBK e ka lënë si numër të biznesit pikërisht numrin personal të Bardiqit. [...]. Duke qenë se nuk kam numër të Kosovës, në procesin e regjistrimit e kam regjistruar numrin e telefonit të Dr. Bardiqit. [...] Me qëllim të ofrimit të shërbimeve të kontraktuara për MSH-në, jam obliguar nga të regjistroj një kompani në Prishtinë. Për ta regjistruar kompaninë në RKS, më është dashur të siguroj një numër të një operatori të Kosovës, në të cilin kam mundur të kontaktoj gjatë punës sime në Kosovë. [...] Nuk kam asnjë marrëdhënie biznesi me Dr. Naim Bardiqin, [...] ndonjë qytetar tjetër të Kosovës”, thuhet në përgjigjet e kreut të “Klmeqo Consulting”, Th. W. drejtuar raportuesit të rastit. [...] Në pyetjet se “si është e mundur që në një kompani që ka marrë punë në MSH, personat kontaktues në këtë kompani të jenë zyrtarë të MSH-së dhe a nuk e keni vlerësuar si “konflikt të mundshëm interesi?, nga kjo ministri thonë se konsulenti gjerman numrin e Bardiqit e ka lënë në ARBK pa lejen e tij. Sipas kësaj ministrie, Th. W., pas kontraktimit si ekspert në MSh, ka vendosur këto të dhëna vetë, mirëpo sipas tyre asnjëherë në konsultim me Sekretarin e Ministrisë së Shëndetësisë. “Konsulenti ka vendos emrin, deri sa ATK e ka kontaktuar personalisht përmes telefonit Sekretarin e Përgjithshëm të MSh-së, ku e ka informuar lidhur me këtë çështje dhe nga kjo, Sekretari i Përgjithshëm i është drejtuar Njësisë Koordinuese të Projektit të BB që të largohet numri i telefonit privat i Sekretarit, për arsye se Sekretari nuk është në shërbim të kompanive dhe nuk ka asnjë relevancë që numri i tij i telefonit të figurojë në kuadër të një kompanie. Sekretari i Përgjithshëm i MSh-së është në shërbim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes”, thuhet në përgjigjen e MSH-së. Por sipas dëshmive të siguruara, sekretari Bardiqi duket të këtë njohje më të hershme me konsulentin gjerman. Bazuar në disa fotografi që ka siguruar [raportuesi i rastit (v.j.)], ai është parë në disa raste t’i këtë shoqëruar zyrtarët e kësaj ministrie në vizita të ndryshme në Gjermani. Njëra prej tyre është e datës 20 qershor 2023, ku në një vizitë në Hamburg të Gjermanisë, delegacioni i Kosovës në krye me sekretarin Bardiqi është nën shoqërimin e konsulentit gjerman, Th. W. Në përshkrimin mbi fotografi, nuk tregohet arsyeja e kësaj vizite në Gjermani”.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresës zyrtare (APK-DPKI-1124/24), ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Naim Bardiqi, lidhur me fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë z. Naim Bardiqi, me ç’rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Në takim, zyrtari i lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, duke theksuar se: “nuk kam asnjë funksion apo rol në “Klmeqo Consulting” L.L.C, e as ndonjë marrëdhënie biznesore me pronarin apo kompaninë në fjalë. Ndërsa, sa i përket vendosjes së numrit tim të telefonit në kompaninë në fjalë, pas kontraktimit si ekspert në MSH të Th. W., i njëjti i ka vendosur këto të dhëna (nr. e telefonit tim) në Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të

*Kosovës (ARBK), pa u konsultuar dhe pa dijeninë time dhe kjo gjë vërtetohet edhe në vet përgjigjen me shkrim të Th. W.*

Tutje, në takim z. Bardiqi deklaroi se, *'në momentin që jam informuar në lidhje me vendosjen e paautorizuar të numrit tim të telefonit nga W., në kompaninë e sipërcituar, kam kërkuar zyrtarisht me shkrim nga ARBK, që menjëherë të bëhet heqja e numrit nga profili i biznesit në fjalë, pasi që nuk ka të bëjë asgjë me mua, duke i njoftuar gjithashtu se, nëse nuk veprohet urgjentisht, me duhet që këtë incident ta raportoj të autoritetet përkatëse në organ mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale. Më pas jam njoftuar nga ARBK se numri im është larguar nga sistemi i ARBK-së.*

Në takim, zyrtari i lartë z. Bardiqi ka deponuar edhe dokumentacion relevant lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit si dhe dokumentacion në mbështetje të qëndrimeve të tij të shprehura në takim, ndërsa, në kompletim të dokumentacionit dhe sqarimit të mëtejshëm të rastit në fjalë, Agjencia ka mbledhur informacion dhe ka bërë verifikimet e nevojshme të tyre në institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Në reagimin e Ministrisë së Shëndetësisë ndaj lajmit publik në media të caktuara për dyshime rreth konfliktit të interesit të zyrtarëve të MSH-së me rastin e dhënies së disa tenderëve, ndër të tjera theksohet se (citojmë): *"[...] Njoftojmë opinionin publik se pretendimet për konflikt interesi në MSh, janë të pa vërteta, për shkak se Sekretari i Përgjithshëm nuk ka asnjë funksion në shoqërinë tregtare të apsotrofuar në artikullin e lartcekur, si dhe nuk ka asnjë marrëdhënie biznesore me z. W. Pra ashtu siç kemi theksuar edhe me herët për Gazetën [...] se: z. W., pas kontraktimit si ekspert në MSH, ka vendosur këto të dhëna në ARBK pa u konsultuar me Sekretarin e Ministrisë së Shëndetësisë. Për më tepër kjo gjë vërtetohet edhe në vet përgjigjen e z. W., në shkrimin e lartcekur, ku thuhet se numri i telefonit është vendosur pa njohurinë dhe pëlqimin e Sekretarit të Përgjithshëm. Ministria e Shëndetësisë sqaron se të dhënat e bizneseve në Kosovë janë publike dhe nga regjistri i bizneseve i ARBK mund të shihet se A. W. është pronare e vetme dhe person përgjegjës i autorizuar nga kompania. Po ashtu, për publikun sqarojmë se vendosja e numrave kontaktues gjatë hapjes së një biznesi, nuk verifikohet nga ana e ARBK-së, prandaj edhe mund të ndodh që personat të cilët bëjnë kërkesë për hapje të biznesi, të vendosin pa autorizim dhe pëlqim numrat e kontaktit të personave të gabuar. Në momentin që Sekretari i Përgjithshëm është informuar në lidhje me vendosjen e paautorizuar të numrit të telefonit nga z. W., është kërkuar menjëherë të bëhet heqja e numrit nga profili i biznesit. [...]"*

Agjencia ka analizuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit për konflikt të mundshëm të interesit si dhe deponimet tjera të ndërlidhura me këtë rast, deklaratat, sqarimet e palës dhe dokumentacionin e siguruar sipas kërkesës së Agjencisë, si dhe provat tjera të siguruar sipas detyrës zyrtare, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me datë 25.11.2020, Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (për klientin: e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së - A. M.) dhe "KIMEGO Consulting" Ltd (për konsulentin: e nënshkruar nga Th. W.,- ekzekutues i marrëveshjes, për aprovim: nënshkruar nga A.W.,- Drejtor i "KIMEGO Consulting" Ltd ), lidhin kontratë për shërbime të konsulencës me Nr. 2.5.2, P147..., me titull: *"Asistencë teknike për të mbështetur vlerësimin e Strategjisë së Sektorit të Shëndetësisë së Kosovës 2017 - 2021"*;

Me datë 24.02.2023, Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (për dhe në emër të Ministrisë së Shëndetësisë e nënshkruar nga z. Naim Bardiqi, Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së), dhe “KIMEGO Consulting” Ltd (për dhe në emër të “KIMEGO Consulting” Ltd, e nënshkruar nga Th. W.), lidhin kontratën për shërbime të konsulencës me nr. XK.-MOH-314...-CS..., me titull: “Zhvillimin e një Vlerësimi Kombëtar të Shëndetit Mendor”

Me datë 24.03.2023, ARBK ka lëshuar certifikatë biznesi me Numër Unik Identifikues 812027771, për “KImego Consulting”<sup>1</sup> L.L.C., Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara, me pronare dhe përfaqësuese të autorizuar A. W., adresë: Str. Zagrebit pn, Nr. kontaktues: +383 44 999 8..<sup>2</sup>;

Me datë 28.08.2024, Sekretari i MSH-së, z. Naim Bardiqi, i drejton kërkesë<sup>3</sup> ARBK-së, për ta larguar numrin e tij (privat) të telefonit nga kompania “KImego Consulting” L.L.C., dhe të njëjtën ditë numri kontaktues në fjalë largohet nga sistemi i ARBK-së dhe i njëjti nuk figuron më të jetë i regjistruar në kompaninë e sipërpërmendur;

Në përgjigjen (email-in) e Th. W., dërguar (për informacion) zyrtarit të MSH-së z. N.SH., lidhur me arsyet e regjistrimit të numrit të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së në “KImego Consulting” L.L.C., ndër të tjera, theksohet se; *“Në mënyrë që të mund t’i ofroj shërbimet e kontraktuara për MSH-në, kam qenë i obliguar me ligj të regjistroj një kompani në Prishtinë. Për të regjistruar kompaninë në RKS, më është dashur të siguroj një numër të linjës telefonike fikse të Kosovës, përmes të cilit do të mund të kontaktohesha gjatë punës sime në Kosovë. Duke qenë se nuk kam numër telefoni të Kosovës, në procesin e regjistrimit e kam futur numrin e telefonit të Dr. Naim Bardiqi, meqë ai ishte udhëheqës i projektit dhe ishte mënyra e vetme për të kontaktuar me mua në një linjë fikse në Kosovë.[...] Nuk kam asnjë marrëdhënie biznesi me Dr. Naim Bardiqin, [...] apo ndonjë qytetar tjetër të Kosovës”;*

Nga informacioni dhe dokumentacioni relevant i siguruar nga MSH, historiku dhe informatat mbi bizneset të siguruara nga ARBK, si dhe informacione/dokumentacione tjera të siguruara nga institucione tjera relevante, përveç rolit dhe funksionit zyrtar të Sekretarit të Përgjithshëm në MSH, përkatësisht ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisive të përshkruara sipas pozitës/vendit të tij të punës, si dhe regjistrimi i numrit të telefonit të z. Naim Bardiqi, nga Th.W., në biznesin “KImego Consulting” L.L.C (mënyra dhe arsyet e të cilit regjistrim u shpjeguan më sipër), Agjencia nuk ka gjetur se z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSH-së, të ketë (pasur) ndonjë funksion në biznesin “KImego Consulting” L.L.C., e as nuk rezulton se ndërmjet këtij biznesi dhe zyrtarit të lartë në fjalë të ketë (pasur) marrëdhënie afariste/biznesore private, lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror apo çfarëdo afërsie tjetër në kuptim të dispozitës përkatëse [personi i afërm me zyrtarin] të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia konstatoi se *nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë*

<sup>1</sup> Sipas Th. Weismann, kompania në fjalë hapet në Kosovë me qëllim të ofrimit të shërbimeve të kontraktuara për MSH-në;

<sup>2</sup> Nr. personal i z. Naim Bardiqi, i cili pas datës 28.08.2024, për arsyet e sipërcekura nuk figuron të jetë më si numër kontaktues në “KImego Consulting” L.L.C;

<sup>3</sup> Email i datës 28.08.2024, i z. Naim Bardiqi drejtuar tek: Info Arbk, cc: S.B. dhe M.K.: “[...] ... numri im privat i telefonit është përdorur në mënyrë të paligjshme, dhe me duhet që të raportoj këtë incident të autoritetet përkatëse në organ mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale po që se nuk marr ndonjë përgjigje sipas afatit ligjor” (cituar nga kërkesa në fjalë);

z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSH-së, vetëm për faktin së numri i telefonit të tij (për arsyt e sipërcekura) ishte regjistruar për një kohë si numër kontakti në biznesin privat "KImego Consulting" L.L.C.

Kësisoj, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare"*.

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se: *"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste"*, si dhe me nën-paragrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se: *"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës."*

Ndërsa, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nocionin vendimmarrje si: *"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."*

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të, në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin.

Në rastin konkret, është fakt se ekziston roli vendimmarrës i z. Naim Bardiqit në cilësinë dhe ushtrimin e përgjegjësive të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së në projektet/kontratat e sipërcekura, por nuk është gjetur se zyrtari i lartë në fjalë të ketë (pasur) interes privat për vete apo personat e afërm me të në çështjen në fjalë, pasi që i njëjti nuk ka asnjë funksion në biznesin "KImego Consulting" L.L.C., nuk rezulton se ndërmjet këtij subjekti (biznesi) dhe zyrtarit të lartë në fjalë ka (pasur) marrëdhënie afariste, apo çfarëdo lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror, e as subjekti privat në fjalë nuk është person i afërm me të, në kuptim të dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me këtë rast, Agjencia konstaton se vetëm fakti i vendosjes së numrit të telefonit të z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSH-së, nga biznesi "KImego Consulting" L.L.C. (veçanërisht marrë parasysh sqarimet dhe arsyt e sipërcekura), mund të jetë (ketë qenë) indicie apo premisë e mjaftueshme për dyshim, por jo fakt i vetëmjaftueshëm për të konstatuar konfliktin e interesit.

Prandaj, edhe përkundër rolit vendimmarrës të z. Naim Bardiqi në cilësinë dhe ushtrimin e përgjegjësi të Sekretarit të Përgjithshëm në MSH në projektin/et dhe ose kontratën/at e sipërcekura, në mungesë të plotësimit të kushtit tjetër kumulativ (*interesi privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të*), në rastin konkret përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera që kanë të bëjnë me procese tenderuese të personave (tjerë) juridik privat e të cilat aspekte nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit sipas legjislacionit përkatës të Agjencisë.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

Yll BULESHKAJ  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)